

Nënprefektët

Në mbështetje të veprimtarisë së prefektit të qarkut dhe në përbërje të administratës caktohen nënprefektët. Prefekti propozon caktimin e funksionit të nënprefektit për një ose më shumë bashki, në zbatim të ligjit për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

Nënprefekti zëvendëson prefektin sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. 1/2. Parashikimet e nenit 7 të këtij ligji për papajtueshmëritë e funksionit të prefektit zbatohen edhe për nënprefektin.

Nënprefekti emërohet apo lirohet, me propozim të prefektit të qarkut, nga ministri.

Nënprefekti për veprimtarinë e vet, për bashkinë/bashkitë përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti i qarkut.

Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve.

1. Në mbështetje të veprimtarisë së prefektit të qarkut dhe në përbërje të administratës caktohen nënprefektët, i cili për veprimtarinë e vet përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti i qarkut.

2. Prefekti i qarkut propozon caktimin e funksionit të nënprefektit për një ose më shumë bashki, në zbatim të ligjit për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

3. Në përputhje me kompetencat e parashikuara në Urdhrin nr. 50 datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së prefektit të qarkut”, nënprefekti:

a. Merr masa dhe informon prefektin për përmbushjen e detyrave të caktuara në zbatim të programit të qeverisë nga institucionet vendore në nivel të bashkisë/bashkive, ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e kompetencave në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për këto institucione;

b. Përpilon raporte e informacione periodike në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c. I propozon prefektit të qarkut masa për zhvillimin ekonomik-shoqëror të bashkisë/ve, ku ushtron funksionet;

d. Informon prefektin e qarkut për masat e marra nga policia e shtetit në nivel të bashkisë/bashkive për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike; Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë, <https://www.mb.gov.al> Faqe 7 nga 43

e. Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e punonjësit të gjendjes civile, si funksion i deleguar;

f. Ushtron kontroll në çdo institucion qendror në nivel të bashkisë/bashkive për marrjen e masave mbrojtëse dhe parandaluese për emergjencat civile;

g. Informon për planet e zhvillimit të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore;

h. Verifikon dhe zgjidh kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, shoqatave e komuniteteve. Për rastet jashtë kompetencës së tij, i propozon prefektit të qarkut mënyrën e zgjidhjes së tyre;

- i. Në programet e punës, nënprefekti krahas detyrave të administratës, përfshin edhe detyra specifike të ngarkuara nga prefekti i qarkut. Për realizimin e detyrave të ngarkuara, nënprefekti raporton periodikisht te prefekti i qarkut; Për probleme të veçanta dhe mundësinë e zgjidhjes së tyre, mban kontakte të drejtpërdrejta me Sekretarin e Përgjithshëm dhe sektorët në përbërje të administratës së prefektit të qarkut;
 - k. Nënprefekti drejton dhe merr pjesë në ceremonitë e ndryshme zyrtare shtetërore që zhvillohen në bashkinë/bashkitë që mbulon si përfaqësues i autorizuar i prefektit të qarkut si dhe në veprimtaritë e organizuara nga organet e vetëqeverisjes vendore kur është i ftuar prej tyre;
 - l. e Për probleme të veçanta, nënprefekti i propozon prefektit të qarkut për mbledhjen e organit këshillues, duke argumentuar paraprakisht domosdoshmërinë e mbledhjes së këtij organi;
 - m. Kontrollon plotësimin e detyrave në institucionet qendrore në territorin e caktuar, në funksion të realizimit të programit të qeverisë. Kërkon përmirësimin e punës në përmbushjen e detyrave dhe informon prefektin e qarkut për punën e bërë prej tyre;
 - n. Përgatit takimet mujore të prefektit të qarkut me drejtuesit e institucioneve qendrore në territorin e caktuar;
 - o. Monitoron veprimtarinë e strukturave të institucioneve qendrore në nivel vendor, të cilat i bën prezent në takimet mujore;
 - p. Zbaton rregullat e etikës të përcaktuara në ligjin nr.9131, date 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
4. Marrëdhëniet e nënprefektit me prefektin e qarkut rregullohen në bazë të dispozitave ligjore dhe rregullores së brendshme të funksionimit të administratës së prefektit të qarkut.